



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

Sot më datë 11.12.2024, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Autoriteti Kontraktor, Drejtorja e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1517/2024 datë 29.10.2024, Vendimit Nr 1578/2024 datë 07.11.2024, Vendimit Nr 1621/2024 datë 18.11.2024, Vendimit Nr 1682/2024 datë 27.11.2024 si dhe Vendimit Nr 1737/2024 datë 10.12.2024 ka kryer modifikimet dhe sqarimet në Dokumentat Standarte të Tenderit, sipas konstatimeve dhe pranimet tërësisht së ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “In Print” SH.P.K dhe pranimet pjesërisht të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SH.P.K për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”/Me marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara/Prokurim Elektronik/Shërbim, me objekt: *“Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të fotokopjimit, printimi dhe skanimit për vitin 2024”*, me fond limit 9,800,000 (nëntë milion e tetëqind mijë) lekë pa T.V.SH, me nr. Ref-24491-10-14-2024, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.10.2024, nga Autoriteti Kontraktor, Drejtorja e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Bazuar në Vendimin Nr 1578/2024 datë 07.11.2024 dhe Vendimin Nr 1737/2024 datë 10.12.2024, Komisioni i Prokurimit Publik ka autorizuar Autoritetin Kontraktor për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës pas ezaurimit të procesit të ankimit.

Duke qenë se kjo procedurë rezulton e pezulluar që me datë 18.10.2024, si rezultat i shqyrtimit të ankesës nga Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik, në mënyrë që të mundësohet një konkurim i drejtë, i hapur, gjithëpërfshirës, i barabartë dhe jo diskrimues, si dhe bazuar në pikën 2 të nenit 75 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Njësia e Prokurimit me unanimitet vendos heqjen e pezullimit të procedurës dhe shtyrjen e afatit të hapjes së ofertave me 7 (shtatë) ditë kalendarike, duke filluar nga data e sotme si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 19.12.2024, Ora: 09:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 19.12.2024, Ora: 09:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Njesia e Prokurimit:

- Kulla Dumani (Person Përgjegjës)
- Orhan Dragoti (Specialist fushe)
- Xhuljano Fuga (Specialist fushe)